



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 489 Akti

Nr. 610 Vendimi

Tiranë, më 27.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 23.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Oltjona Goxha**, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe e dëgjoji atë në seancë dëgjimore, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Oltjona Goxha është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Oltjona Goxha i është nënshtruar procesit të

rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Në datën 26.6.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin po në këtë datë deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, subjekti, po në të njëjtën datë, nëpërmjet postës elektronike depozitoi një kërkesë paraprake me objekt “mosfillimin e procedurës së rivlerësimit”, duke parashtruar, ndër të tjera, se: *“Duke shprehur vlerësim dhe konsideratë maksimale për procesin e rivlerësimit, ju bëj me dije se unë, magjistrate Oltjona Goxha, kam marrë titullin ‘magjistrat’ në datën 20.1.2017 dhe jam caktuar në pozicion në datën 10.2.2017, me vendimet respektive të KLD-së, duke u kryer nga kjo e fundit verifikimet përkatëse, në zbatim të nenit 160 të ligjit ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’. Ky i fundit, në mënyrë specifike për kandidatët për magjistratë të viteve 2013 – 2016 (të cilëve u përkas edhe unë) e detyronte KLD-në të merrte vendimet e mësipërme, duke kryer të njëjtat verifikime (për të tria kriteret), si i kryen aktualisht KLGJ-ja për kandidatët për magjistratë dhe KPK-ja për gjyqtarët dhe prokurorët që kanë qenë në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit ‘Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’. Për rrjedhojë të sa më sipër, në referim të nenit 179/b të Kushtetutës, vlerësoj se nuk jam subjekt i ligjit ‘Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’, i cili ka hyrë në fuqi në muajin tetor të vitit 2016, ndërsa unë jam caktuar në pozicion në muajin shkurt të vitit 2017.*

Është e vërtetë që nga muaji nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016 kam kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por ai ka qenë pjesë e formimit fillestar të shkollës, gjë që cilësohej specifikisht në ligjin ‘Për Shkollën e Magjistraturës’ dhe rikonfirmohet po në mënyrë specifike në nenin 160 të ligjit për statusin, i cili na ka cilësuar ‘kandidat për magjistratë’. Gjatë stazhit profesional ne nuk vlerësoheshim nga KLD-ja, por nga stafi pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës dhe nëse ndonjëri prej nesh merrte vlerësimin ‘dobët’, ai nuk merrte titullin dhe as nuk caktohej në detyrë. E njëjta gjë ndodhte nëse ndonjë kandidat kryente shkelje disiplinore, gjë e cila do të thotë se stazhi profesional nuk mund të konsiderohet si moment i fillimit të detyrës. Për më tepër që ne nuk mund të jemi pjesë e dy dispozitave të të njëjtit ligj (ligjit për statusin) në të njëjtën kohë.

Ne si brez i jemi drejtuar me kërkesë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për përjashtimin tonë nga procesi i rivlerësimit. Në këtë kërkesë janë dhënë arsye më të detajuara lidhur me sa më sipër. Unë nuk jam në dijeni që Komisioni të ketë marrë ndonjë vendim, ndaj duke pasur besim që ju do ta merrni në shqyrtim kërkesën time, do ju lutesha që përpara përfundimit të afatit që më keni caktuar të merrni një vendim lidhur me faktin nëse unë jam subjekt. Së fundmi,

duke qenë tërësisht e gatshme për të bashkëpunuar, do ju lutesha të më caktoni një afat të ri për t'iu përgjigjur pyetësorit bashkëlidhur”.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, menjëherë pas marrjes së kërkesës nga subjekti, pasi ka diskutuar dhe vlerësuar rrethanat faktiko-ligjore, si dhe kontekstin në momentin e nisjes së karrierës së saj profesionale, njoftoi znj. Oltjona Goxha me anë të postës elektronike mbi vendimin e ndërmjetëm të tij, sipas të cilit ajo duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si subjekt rivlerësimi dhe se ky vendim do të arsyetohej në vendimin përfundimtar.

7. Trupi gjykues, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur se kryerja e procesit të rivlerësimit ndaj znj. Oltjona Goxha duhet të vijojë, me arsyetimin se:

- i. Sipas të dhënave nga dokumentet e administruara nga Komisioni, ka rezultuar se znj. Oltjona Goxha në periudhën tetor 2013 – tetor 2015 ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu, referuar shkresës nr. *** prot., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga vetë pohimet e subjektit të rivlerësimit Oltjona Goxha në periudhën nëntor 2015 – korrik 2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (stazhin profesional).
- ii. Me Dekretin Nr. ***, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës, emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- iii. Me vendim nr. ***, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, caktohet për të ushtruar funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon të ushtrojë detyrën edhe aktualisht.
- iv. Nisur nga ky moment e në vijim, znj. Oltjona Goxha ka shqyrtuar çështje të ndryshme dhe të shumta, duke vendosur lidhur me themelin e tyre. Kësisoj, ajo ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në sistemin e drejtësisë shumë kohë përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016, si dhe ndryshimet kushtetuese, që kanë parashikuar dhe rregulluar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
- v. Rrethanat e lartpërmendura – të para nën optikën e një vlerësimi krahasimor dhe të analizuar në harmoni me frymën e ligjit dhe për analogji, në raport me aktivitetin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (gjithashtu të cilësuar si subjekte rivlerësimi *ex officio*, në nenin 179/B, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës) – përbëjnë më shumë shkaqe legjitimuese për kryerjen e procesit të rivlerësimit ndaj gjyqtarëve stazhierë, thjesht për faktin se këta të fundit kanë shqyrtuar të vetëm dhe kanë dhënë vendime mbi çështjet gjyqësore përkatëse, ndërsa këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë kanë qenë të përfshirë në një funksion jovendimmarrës, por thjesht dhe vetëm ndihmës apo përgatitorë/sugjerues.
- vi. Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se lidhur me subjektet *ex officio*, dispozita përkatëse, në pikën 3 të nenit të lartpërmendur, shprehet me terma të përgjithshëm gjyqtarë, prokurorë etj., pa bërë dallim midis gjyqtarëve stazhierë dhe atyre të emëruar pas kryerjes së stazhit profesional, duke lënë kësisoj vend për interpretim ligjor.

Në këto kushte, interpretimi dhe vlerësimi i rastit konkret, nisur nga sa u përshkrua më sipër, si dhe duke mbajtur në vëmendje edhe faktin se znj. Oltjona Goxha ka plotësuar dhe dorëzuar

rregullisht dhe në kohë deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, prej vitit 2015, e të tjerat në vijim, përfshirë edhe deklaratat, formularët dhe dokumentet e kërkuara pikërisht pas futjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ka dorëzuar formularët për pasurinë dhe figurën dhe vlerësimin profesional, duke përmbushur me vullnetin e saj të lirë dhe të pavesuar detyrimet ligjore të kërkuara nga ligji nr. 84/2016, duke e konsideruar kështu veten subjekt rivlerësimi të këtij ligji.

8. Trupi gjykues, më pas, vijoi dhe përfundoi hetimin administrativ për këtë subjekt rivlerësimi dhe vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Oltjona Goxha; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

9. Në datën 13.12.2022 subjektit të rivlerësimit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave e shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

10. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti brenda afatit të caktuar, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 23.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

11. Në datën 23.12.2022, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

11.1. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 27.12.2022.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11.2. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

12. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Oltjona Goxha, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

- nuk ka kryer deklarin të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/1. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

12.1. Referuar vendimit nr. 2/20173 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi si vijon:

13. Automjet tip “*”, viti i prodhimit 2005**

13.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “*Autoveturë marka ‘***’, tipi ‘***’, viti i prodhimit 2005. Burimi i krijimit: dhuratë nga familja para fillimit të detyrës. Vlera: 980.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

13.2. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pasuri, ka depozituar: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 24.10.2011, me shitës A. K. dhe blerës Oltjona Goxha dhe D. G., të automjetit të tip “***”, me vlerë 980.000 lekë; (ii) certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar në datën 26.10.2011.

13.3. Në deklarin e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (data emërimi në detyrë 20.11.2015) subjekti i rivlerësimit (në pozicionin e gjyqtarës stazhiere), në seksionin “deklarin të pasurive dhe burim të krijimit”, ndër të tjera, ka deklaruar: “*...autoveturë marka ‘***’, tipi ‘***’, vit prodhimi 2005, në shumën 980.000 lekë, bazuar në kontratën e shitjes datë 24.10.2011 (burimi i krijimit dhuratë nga familja). Pjesa takuese: 50%*”.

13.4. Në deklaratën e interesave privatë të viteve 2015 - 2016, subjekti i rivlerësimit nuk deklaron ndryshime në lidhje me këtë pasuri.

13.5. Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 24.10.2011, subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha dhe motra e saj, shtetasja D. G., kanë blerë nga shtetasi A. K. automjetin tip “***”, për shumën 980.000 lekë.

13.6. Ky automjet është blerë nga shtetasi A. K., me faturë datë 15.6.2011, në shumën 3.500 euro në Gjermani. Në bazë të deklaratës doganore nr. ***, datë 5.7.2011, është kryer zhdoganimi i këtij automjeti dhe janë llogaritur detyrimet doganore në vlerën 280.995 lekë. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021¹, rezulton se vlera e automjetit në doganë është rivlerësuar nga 3.500 euro në 1.006.551 lekë dhe detyrimet doganore të rillogaritura dhe të paguara janë në vlerën 378.430 lekë.

13.7. AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2020, ka konfirmuar për Komisionin mbulimin me sigurim të automjetit të sipërcituar nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke filluar nga data 26.10.2011.

Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë dhe mundësinë financiare

¹Pjesë e dosjes së subjektit D. G. (motra e subjektit të rivlerësimit), administruar me vendimin datë 28.3.2022, të trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

13.8. Në deklaratën *Vetting*, subjekti, për automjetin tip “***”, ka deklaruar *burim krijimi dhuratë nga familja para fillimit të detyrës në vlerën 980.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*.

13.9. Në lidhje me burimin e të ardhurave të automjetit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... për pjesën time takuese 50%, burim kanë qenë të ardhurat e familjes, ndërsa për pjesën e motrës time kanë shërbyer si burim të ardhurat e saj...”. Gjithashtu, subjekti sqaron se: “... shpjegimet dhe dokumentacioni i plotë provues lidhur me burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit, si për sa i përket pjesës takuese të motrës sime, ashtu edhe sa i përket pjesës sime takuese, ndodhet në dosjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit D. G.”.

13.10. Komisioni, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit të posaçëm nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. *** të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, vendosi të marrë në cilësinë e personit tjetër të lidhur familjen e subjektit, deklaruar në cilësinë e dhuruesve, dhurim i konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

13.11. Komisioni, nisur nga burimi i të ardhurave të deklaruara nga subjekti, numrit të anëtarëve të familjes, ka vlerësuar që për llogaritjen e mundësisë financiare të familjarëve të subjektit për blerjen e automjetit tip “***” me kontratën e datës 24.10.2011, të përfshihen në analizë prindërit, motra dhe vëllezërit e subjektit.

Në lidhje me të ardhurat e prindërve të subjektit

13.12. Referuar informacionit të marrë nga ISSH-ja rezulton që shuma e të ardhurave nga paga për periudhën 2001 – 2008, për babain e subjektit, rezulton në vlerë *bruto* 1.339.294 lekë. Ndërsa për nënën e subjektit informacioni i përket periudhave të mëpasshme.

13.13. Në lidhje me aktivitetin privat të ushtruar nga prindërit e subjektit, si dhe të ardhurat e deklaruara të përfituara prej tyre, QKB-ja, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.3.2021, informon Komisionin se:

i) Shtetasi F. G. figuron administrator dhe ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “***” sh.p.k., regjistruar në datën 31.1.2001, kaluar në status “pezulluar” në datën 23.6.2010. Gjithashtu, shtetasi F. G. figuron të ketë qenë ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “***” sh.p.k., për periudhën 21.4.2014 – 29.3.2018.

ii) Kjo shoqëri është krijuar në datën 14.9.2009 dhe në bazë të aktit të themelimit ortak dhe administrator i shoqërisë ka qenë shtetasi S. G.

iii) Shtetasja Xh. G. figuron të ketë qenë administratore dhe është ortake me 100% të kuotave në shoqërinë “***” sh.p.k. Referuar ekstraktit historik, kjo shoqëri në datën 28.2.2011 ka kaluar në statusin “pezulluar”.

13.14. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.7.2021, informon Komisionin (në përgjigjen lidhur me subjektin e rivlerësimit Oltjona Goxha se:

i) Shtetasi F. G. rezulton i regjistruar si administrator i subjektit tregtar “***” me NIPT ***, i regjistruar në sistemin tatimor në datën 31.1.2001. Në bazë të informacionit të përcjellë me këtë shkresë rezulton se të ardhurat (fitim pas tatimit) e deklaruara nga ky subjekt për periudhën

2002 – 2010 kanë qenë në vlerën 6.763.872 lekë (viti 2006 dhe 2010 rezultojnë në humbje, përkatësisht 160.496 lekë dhe 718 lekë). Kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend.

ii) Shtetasja Xh. G. rezulton si administratore e subjektit tregtar “****” sh.p.k., me NIPT ***, e regjistruar në sistemin tatimor në datën 18.5.2010, me aktivitet “tregti”. Në këtë shkresë nuk pasqyrohen të ardhura (fitime) të deklaruara nga ky subjekt për periudhën 2010 – 2011.

Në lidhje me të ardhurat e dokumentuara të motrës së subjektit, znj. D. G.

13.15. Në bazë të vërtetimit nr. *** prot., datë 18.5.2021, të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se shtetasja D. G. ka përfituar nga ky institucion një pagë *neto* për vitin 2010 në vlerën 127.500 lekë dhe për harkun kohor janar – tetor 2011 në shumën 427.125 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e vëllezërve të subjektit

13.16. Arkivi Qendror i Sigurimeve Lundër, me shkresën kthim përgjigjeje nr. ***, datë 10.5.2022, ka informuar Komisionin se:

i) Për shtetasin S. G. rezultojnë të pasqyruara në vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, të ardhura për të cilat është derdhur kontribut në subjektin “****” sh.p.k., konkretisht pagë *bruto* nga tetori i vitit 2010 (në vlerën 240.000 lekë për vitin 2010 dhe 960.000 lekë për vitin 2011).

ii) Për shtetasin E. G. rezultojnë të pasqyruara në vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, të ardhura për të cilat është derdhur kontribut në subjektin fizik “****”, konkretisht pagë *bruto* për vitin 2010 (shkurt - dhjetor) në shumën 181.520 lekë, ndërsa për periudhën deri në tetor të vitit 2011 në vlerën 171.080 lekë.

13.17. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.5.2022, ndër të tjera, informon Komisionin se subjekti “****” person fizik, me NIPT ***, është regjistruar pranë këtij institucioni në datën 24.2.2010, ndërsa, për sa i përket të ardhurave (qarkullimi) të parashikuara/realizuara ose fitimit të realizuar për periudhën 2010 – 2011, është shprehur se nuk ka të dhëna.

13.18. Znj. D. G. (motra e subjektit, në prapësimet e barrës së provës të Komisionit gjatë rivlerësimit të saj si subjekt rivlerësimi), në lidhje me të ardhurat e vëllait E. G. nga aktiviteti tregtar, ndër të tjera, ka deklaruar se: “*Vëllai im E. G. ka qenë i regjistruar si person fizik prej datës 25.2.2010 dhe rezulton të ketë bërë edhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të ketë paguar taksat. Të ardhurat nga paga janë marrë, tërhequr, prej tij si individ dhe janë llogaritur si shpenzim në të ardhurat e personit fizik...*”.

13.19. Në bazë të pasqyrave financiare të subjektit tregtar “E. G.”, person fizik, për periudhën kontabël 1.1.2011 – 31.12.2011, dorëzuar pranë DRT-së Tiranë në datën 26.3.2012, rezulton se fitimi *neto* për vitin 2010 (kolona viti paraardhës) është deklaruar në vlerën 561.000 lekë, ndërsa fitimi *neto* për vitin 2011 është deklaruar në vlerën 612.000 lekë.

13.20. Në lidhje me fitimin për vitin 2011, Komisioni, në vlerësim të faktit që automjeti është blerë në tetor të vitit 2011, vendosi të pasqyrojë në analizë të ardhura, fitim për vitin 2010, shumën 561.000 lekë dhe për vitin 2011, të mesatarizuar shumën 510.000 lekë.

13.21. Sa më sipër, Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, deklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin pjesë të dosjes së znj. D. G., kreu një analizë paraprake financiare për mundësinë e blerjes së automjetit tip “***” në datën 24.10.2011, në vlerë 980.000 lekë. Kjo analizë përfshiu të ardhurat e familjarëve të saj për periudhën 2007 – 24.10.2011, si dhe shpenzimet e konsumit jetik për këtë periudhë, nga e cila duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “***”, dhuruar nga familjarët me kontratën e datës 24.10.2011, në shumën 980.000 lekë, subjektit dhe motrës së saj.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

13.22. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar se pasuria është krijuar përpara se ajo dhe motra e saj të fillonin detyrat respektive si gjyqtare dhe se Komisioni nuk ka përfshirë në mënyrë të plotë të ardhurat e saj dhe të familjarëve, si dhe nuk ka marrë në konsideratë aktivitetin e tyre ekonomik të mëparshëm, i cili rezulton tërësisht i provuar me dokumentacionin administruar nga Komisioni.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

13.23. Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklarimet në seancën dëgjimore, vlerëson si vijon:

13.24. Detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie legjitimohet nga jurisprudenca e Kolegjit, e cila përcakton se subjekti është i detyruar të provojë ligjshmërinë e burimit për kryerjen e investimit për secilin prej bashkëpronarëve në rastet kur subjekti është ndodhur në ekonomi të përbashkët familjare me personat me të cilët gëzon bashkëpronësinë e pasurisë së blerë.

13.25. Pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti së bashku me shpjegimet e dhëna prej saj dhe pas përfshirjes në analizë të të ardhurave nga aktiviteti i vëllait “***”, person fizik, për vitet 2010 - 2011, si dhe pagat e tij gjatë periudhës që ka banuar së bashku me familjen, ka rezultuar se familja e subjektit ka pasur mjaftueshmëri financiare për blerjen e pasurisë në fjalë, me burime të ligjshme financiare.

13.26. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe ka shpjeguar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të dhuruar, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 32 të ligjit nr. 84/2016.

14. Gjendje cash në vlerën 1.000.000 lekë

14.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “Gjendje cash jashtë sistemit bankar në shumën 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga bursa e Shkollës së Magjistraturës, si dhe shpërblim si anëtare e bordit drejtues të Shkollës së Magjistraturës para fillimit të detyrës. Pjesa takuese: 100%”. Ndërsa në rubrikën “angazhime dhe veprimtari

private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, pjesë e deklaratës *Vetting* subjekti ka deklaruar vetëm të ardhurat nga paga *neto* si gjyqtare (stazhiere) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2015 - 2016 në shumën totale 1.082.072 lekë (përkatësisht 110.324 lekë dhe 971.748 lekë), si dhe të ardhura nga shpërblimi *neto* si anëtare e këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2016 në vlerën 42.500 lekë.

14.2. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në datën 20.11.2015, në seksionin “deklarim i pasurive dhe burim i krijimit”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar *gjendje cash jashtë sistemit bankar në shumën 1.000.000 lekë, me burim nga kursimet nga bursa e Shkollës së Magjistraturës, si dhe shpërblim si anëtare e bordit drejtues të Shkollës së Magjistraturës për periudhën 3.11.2013 – 20.11.2015*.

14.3. Në DIPV-të e viteve 2015 - 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa dhe pakësime të gjendjes *cash* në banesë.

Analizë e burimit të krijimit të gjendjes *cash* në vlerën 1.000.000 lekë

14.4. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si një ndër burimet e krijimit të gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 1.000.000 lekë, të ardhurat nga kursimet.

14.5. Në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2015, në rubrikën “angazhime”, subjekti ka deklaruar: “*Bursë Shkolla e Magjistraturës, candidate për gjyqtare deri në datën 30.9.2015, në shumën 471.852,000 lekë, si dhe shpërblim si anëtare e bordit drejtues të Shkollës së Magjistraturës në shumën 51.085,000 lekë*”.

14.6. Në seksionin “angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, pjesë e deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga *neto* si gjyqtare (stazhiere) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2015 - 2016 në shumën totale 1.082.072 lekë (përkatësisht 110.324 lekë dhe 971.748 lekë), si dhe të ardhura nga shpërblimi *neto* si anëtare e këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2016 në vlerë 42.500 lekë.

14.7. Referuar dokumentacionit, pjesë të dosjes *Vetting*, ndër të tjera, subjekti ka bashkëlidhur edhe: (i) vërtetim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me anë të të cilit vërtetohet se për harkun kohor 1.4.2009 – 30.9.2009 ka qenë e punësuar pranë këtij institucioni; si dhe (ii) vërtetim datë 21.10.2016, të SHÇBA-së, me anë të të cilit vërtetohet se ka punuar në këtë institucion për periudhën prill 2010 – mars 2011.

14.8. Nisur nga fakti që në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 18.12.2015, subjekti ka deklaruar si burim të likuiditeteve gjendje *cash* jashtë sistemit bankar (shuma 1.000.000 lekë) vetëm kursimet nga bursa e Shkollës së Magjistraturës, si dhe shpërblim si anëtare e bordit drejtues të Shkollës së Magjistraturës për periudhën 3.11.2013 – 20.11.2015, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 i është kërkuar të deklarojë duke specifikuar burimin e të ardhurave për krijimin e këtyre vlerave monetare, gjendje *cash* në datën 20.11.2015.

14.9. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: “*...në pjesën e deklaratës Vetting që trajton seksionin e angazhimeve, nga ana ime janë plotësuar vetëm të ardhurat nga paga neto si gjyqtare (stazhiere) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2015 - 2016, si dhe të ardhura nga shpërblimi neto si anëtare e Këshillit Drejtues të Shkollës*

së Magjistraturës për vitin 2016, për shkak të mënyrës time të kuptimit të kësaj pjese të deklaratës, duke i lidhur këto të ardhura me momentin e fillimit të detyrës sime e në vijim. Për këtë shkak nuk janë plotësuar nga ana ime të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës dhe punësimet e mia të mëparshme në këtë pjesë të deklaratës... ”.

14.10. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, kreu një analizë paraprake financiare për periudhën 25.10.2011 – 20.11.2015, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të kursyer shumën 1.000.000 lekë në datën 20.11.2015, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për këtë periudhë. Në këtë analizë janë pasqyruar të ardhurat e dokumentuara të subjektit të rivlerësimit, shpenzimet e evidentuara dhe llogaritura, si dhe gjendjet e likuiditeteve *cash* dhe në llogaritë bankare në fillim dhe në fund të periudhës, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur të dokumentojë burimet e të ardhurave për krijimin e shumës 1.000.000 lekë, të deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në datën 20.11.2015 dhe në deklaratën *Vetting*.

14.11. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe shpjeguar burimet e ligjshme për krijimin e likuiditeteve në gjendje *cash*, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 84/2016.

15. Apartament banimi, në përdorim, në rrugën “**”, Tiranë**

15.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “deklarimi i pasurive”, ka deklaruar si adresë vendbanimi: “*Apartament që ndodhet në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga ****, Tiranë, i cili është fituar nga shtetasi F. G. (babai i deklaruases) me kontratën e shitjes nr. ***, datë 1.9.1997. Vlera: 56.000 USD. Zotëron: 0%*”.

15.2. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin: (i) kontratë shitjeje nr. ***, datë 1.9.1997, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasin F. G., për blerjen e një apartamenti me sip. 116 m², me vlerë totale 56.000 USD. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 dhe në deklaratën periodike të viteve 2015 - 2016 subjekti ka deklaruar të njëjtën adresë vendbanimi.

15.3. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, e pyetur në lidhje me adresën e banimit, deklaroi se: “*Nga momenti i fillimit të detyrës kam jetuar në Tiranë në apartamentin në bashkëpronësi të prindërve F. dhe Xh. G., që ndodhet në adresën: rruga ****, Tiranë, banesë e blerë nga prindërit përpara fillimit të detyrës sime*”.

15.4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2021 dhe shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2021, informon Komisionin se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

15.5. Ndërsa, sipas informacionit pjesë e dosjes së ILDKPKI-së², ZQRPP-ja, me *email*-in e datës 20.9.2018, konfirmon se në emër të babait të subjektit, z. F. G., figuron e regjistruar pasuria e llojit “apartament” me sip. 116 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, duke i bashkëlidhur praktikës: (i) certifikatën e pronësisë, sipas së cilës kjo pasuri është e bllokuar në favor të BKT-së për kreditë e marrë nga shtetasit F. G. dhe Xh. G. në datën 15.7.2013, në shumën 10.000.000 lekë; (ii) kartelën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit

²Pjesë e dosjes *Vetting*.

“apartament” me sip. 116 m², në pronësi të shtetasit F. K. G., me datë lëshimi certifikate 1.8.2013, me shënimin “bllokohet në favor të BKT-së për shumën 10.000.000 lekë”; (iii) kontratën e hipotekës me nr. ***, datë 15.7.2013, me palë huadhënëse BKT-në dhe palë huamarrëse F. G. dhe Xh. G. (shoqëria “****” sh.p.k.) për shumën 10.000.000 lekë.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

15.6. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se: *“Në lidhje me shpjegimet që më kërkohen nga Komisioni për burimin e të ardhurave të prindërve në pasurinë apartament banimi në rr. ‘****’ babai im që kur ka përfunduar arsimin e lartë e deri në vitin 1995 ka qenë i punësuar në shtet. Prej vitit 1993 është marrë edhe me tregti me produkte të ndryshme, kryesisht ushqimore dhe industriale. Ai ka themeluar shoqërinë tregtare ‘****’ sh.p.k., të cilën e ka regjistruar në gjykatë në vitin 1996. Të dy prindërit më pohuan se si burim për blerjen e pasurisë së sipërcituar ka shërbyer aktiviteti tregtar i babait tim dhe kursimet e tyre në vite”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

15.7. Trupi gjykues, pasi administroi provat e mbledhura gjatë hetimit, provat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, arsyeton se lidhur me marrëdhënien e përdorimit nga ana e subjektit të apartamentit në pronësi të babait të saj vlerëson se nuk provohet me asnjë dokument që subjekti i rivlerësimit të ketë paguar detyrimin financiar për këtë marrëdhënie. Në kuptim të përkufizimit “persona të tjerë të lidhur”, të dhënë nga neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, që personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit të konsiderohet i tillë duhet të provohet një lidhje interesi mes tyre, që vjen si pasojë e: (i) një interesi pasuror; ose (ii) çdo marrëdhënieje tjetër biznesi.

15.8. Lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është përcaktuar në nenin 32, pika 4 e këtij ligji, i cili parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.*

15.9. Vlerësimi lidhur me përdorimin e apartamentit të babait nga ana e subjektit të rivlerësimit pa pagesë qiraje, është trajtuar nga Kolegji në vendimin nr. 7, datë 24.6.2020.

15.10. Në mbështetje të arsyetimit të mësipërm, situatës faktike dhe juridike, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit të përdorur prej saj, pasi babai i subjektit nuk plotëson kërkesat e këtyre dispozitave ligjore për t’u konsideruar person tjetër i lidhur, që do ta vendosnin atë përpara këtij detyrimi, i cili konsiderohet në tejkallim të parashikimeve kushtetuese e ligjore.

15.11. Pavarësisht sa më sipërarzsyetuar, trupi gjykues, në kuadër të parashikimit të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pasurinë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, ka analizuar dhe evidentuar marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit

me pasurinë në përdorim, si dhe ka verifikuar çdo fakt dhe rrethanë që mund të ngrinte dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë në përdorim të saj, si dhe ka verifikuar kohën e krijimit dhe burimet e përdorura nga babai i subjektit.

15.12. Trupi gjykues, pasi ka vlerësuar se blerja e kësaj pasurie i referohet një periudhe kohore shumë më të hershme se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrën e gjyqtarës; pasuria është regjistruar në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në emër të prindërve të subjektit; dhe pavarësisht periudhës së gjatë dhe të largët të burimit të përfitimit të këtyre të ardhurave nga prindërit e saj, subjekti me dokumentacionin e depozituar në cilësinë e provës, ka arritur të provojë mundësinë e babait për krijimin e të ardhurave, ka arritur në konkluzionin se nuk evidentohen dyshime apo paraqitje e pasaktë e kësaj pasurie nga ana e subjektit dhe se ajo ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit për këtë pasuri.

16. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në datën 24.1.2017

16.1. Subjekti e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë llogari me gjendje në shumën 40.000 lekë në datën 24.1.2017.

16.2. Referuar informacionit nga “Raiffeisen Bank”³ rezulton se gjendja e llogarisë rrjedhëse të pagës në emër të subjektit të rivlerësimit në këtë bankë në datën 25.1.2017 (data e dorëzimit të deklaratës *Vetting*) ka qenë në vlerën 40.006 lekë. Në këtë llogari janë kredituar vlerat e pagës së përfituar nga subjekti nga marrëdhëniet e punës, si dhe honorar nga Shkolla e Magjistraturës. Të dhënat në lidhje me gjendjet e kësaj llogarie bankare janë përfshirë në analizën paraprake financiare të kryer nga Komisioni.

16.3. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me gjendjen e kësaj llogarie bankare.

17. Analiza e treguesve financiarë për periudhën e deklaramit

17.1. Mbështetur në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ dhe deklarameve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2015, si dhe për vitin 2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për krijim të pasurive (likuiditete), si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për këto periudha, pasqyruar në tabelën si vijon:

Analiza paraprake e treguesve financiarë	Periudha nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2015	Viti 2016
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën	29.345	997.248
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës bursë/honorare	0	17.000
Total të ardhura/të hyra financiare	29.345	1.014.248
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit për periudhën	0	114.946

³Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.12.2020.

Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën (për 1 person ⁴)	25.807	235.092
Total shpenzime/të dala financiare	25.807	350.038
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0	0
Ndryshim mjete monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	15.655	102.725
Mjete monetare të disponueshme	19.193	766.936

17.2. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2015, si dhe për vitin 2016, ka pasur mundësi financiare për krijim të pasurive (likuiditete), si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme.

Gjetje të tjera gjatë hetimit administrativ

18. Lidhur me një situatë konflikti interesi

18.1. Përgjatë hetimit administrativ rezultuan: (i) kontratë kredie bankare lidhur në datën 6.3.2015, me palë Xh. G., në cilësinë e huamarrëses, F. G., në cilësinë e dorëzanësit dhe Banka Kombëtare Tregtare, në cilësinë e huadhënësit, kanë marrë një kredi në vlerën 2.000.000 lekë, me afat shlyerjeje 3 muaj, të siguruar me bllokim shume; (ii) kontratë kredie bankare lidhur në datën 5.6.2015, me palë Xh. G., në cilësinë e huamarrëses, F. G., në cilësinë e dorëzanësit dhe Banka Kombëtare Tregtare, në cilësinë e huadhënësit, kanë marrë një kredi në vlerën 2.000.000 lekë, me afat shlyerjeje 12 muaj, të siguruar me bllokim shume; (iii) kontratë kredie bankare (konsumatore), me afat shlyerjeje 24 muaj, lidhur në datën 9.6.2016, me palë Xh. G., në cilësinë e huamarrëses, F. G., në cilësinë e dorëzanësit dhe Banka Kombëtare Tregtare, në cilësinë e huadhënësit, kanë marrë një kredi në vlerën 2.000.000 lekë, të siguruar me bllokim shume; (iv) kontratë kredie lidhur në datën 15.7.2013, si dhe kontratë kredie me afat, datë 29.12.2014, me palë shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e huamarrësit, me përfaqësues S. G., shtetasit S. G., F. G. dhe Xh. G., në cilësinë e dorëzanësit dhe Banka Ndërkombëtare Tregtare, në cilësinë e huadhënësit, kanë marrë një kredi në vlerën 10.000.000 lekë.

18.2. Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵, subjekti rezultoi se ka gjykuar: (i) çështjen civile me nr. *** akti, datë regj. 24.4.2017, me palë paditëse A. J. dhe palë të paditur përmbaruesi gjyqësor I. E. dhe Banka Ndërkombëtare Tregtare, me objekt “Anulimi i veprimeve përmbarimore, njoftuar me shkresën nr. ***, *** regj., nr. *** prot., datë 19.4.2017, të përmbaruesit gjyqësor I. E., ‘Për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm; pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbarimore njoftuar me shkresën nr. ***, *** regj., nr. *** prot., datë 19.4.2017, të përmbaruesit gjyqësor I. E., ‘Për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm”. Në datën 4.5.2017 subjekti ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. ***, datë 24.4.2017; (ii) çështjen civile me nr. ***, me palë paditëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë të paditur Banka Kombëtare Tregtare, me objekt “Shuarja e detyrimit të palës paditëse

⁴Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...gjatë periudhës së deklaramit kam jetuar me prindërit, si dhe me motrën time...shpenzimet për jetesë për pjesën time janë përballuar nga unë nga të ardhurat nga paga, të ardhura këto që janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore të deklaramit të pasurisë pranë ILDKPKI-së, si dhe në deklaratën Vetting...”.

⁵Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.5.2022.

shoqëria ‘***’ sh.p.k. ndaj palës së paditur Banka Kombëtare Tregtare, për sa i përket kontratës së kredisë me nr. ***, datë 20.4.2006; shpërblimi i dëmit të ardhur si pasojë e bllokimit të pasurive të lëna si garanci përtej kohës së përmbushjes së detyrimit”. Në datën 20.4.2018 është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes civile nr. ***.

18.3. Ndodhur para fakteve të mësipërme, subjekti u pyet nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe nëse duhet të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve të mësipërme (neni 72 i Kodit të Procedurës Civile) në kushtet kur shtetasit S. G. (vëllai i subjektit), F. G. (babai i subjektit) dhe Xh. G. (nëna e subjektit) janë në një marrëdhënie të vazhdueshme interesi me njërin nga palët në çështjet që ka gjykuar.

18.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes, sqaroi se: *“Ashtu sikurse relatohet nga ana juaj dhe rezulton e provuar nga dokumentacioni që keni administruar, në asnjërën prej marrëdhënieve kontraktore të mësipërme unë nuk jam palë kontraktore. Në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile nën titullin ‘Rastet për përjashtimin e gjyqtarit’ janë të renditura rastet kur gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje... Ndërsa në nenin 73 të Kodit të Procedurës Civile nën titullin ‘Heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes’, përcaktohet se: ‘Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij”.*

18.5. Pas përgjigjeve të subjektit në pyetësor se: (i) familjarët e subjektit kanë aplikuar dhe kanë marrë kredi me të njëjtat kushte si qytetarët e tjerë; (ii) pothuajse të gjitha kontratat e mësipërme kanë qenë të lidhura përpara se subjekti të fillonte të ushtronte funksionin si gjyqtare dhe përpara se të fillonte stazhin profesional (nëntor 2015) dhe kushtet e kontratave kanë qenë të paracaktuara nga palët; (iii) marrëdhënie nga të cilat nuk rezultuan të ketë lindur ndonjë mosmarrëveshje mes palëve, prezente në kohën e pjesëmarrjes së subjektit të rivlerësimit në çështjet civile objekt gjykimi (në vitin 2016) – trupi gjykues çmoi se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm se nuk ka pasur detyrimin ligjor për të hequr dorë nga gjykimi i çështjeve të sipërpërmendura, sipas parashikimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

19. Lidhur me hua të marra/kthyera nga shtetasi F. G. (babai i subjektit)

19.1. Në bazë të informacionit të administruar pranë Komisionit rezulton se me deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.11.2015, shtetasi A. F. L. ka deklaruar se i ka dhënë shtetasit F. G. hua shumë 40.000 euro, e cila do të likuidohej deri në datën 24.11.2016.

19.2. Gjithashtu, me deklaratën noteriale për njohje detyrimi nr. ***, datë 31.1.2017, shtetasi F. G. ka deklaruar se i ka marrë shtetasit B. H. hua shumë 4.160.000 lekë në tetor të vitit 2016, e cila do të likuidohej brenda datës 31.10.2017, ndërsa me deklaratën noteriale për likuidim detyrimi nr. ***, datë 12.12.2018, shtetasit B. H. dhe F. G. deklarojnë se huaja është shlyer me këste të ndara në periudha të ndryshme.

19.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“...asnjëra prej këtyre shumave nuk ka shërbyer si kursim, investim, dhurim apo burim për ndonjë pasuri të timen...”.*

19.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.5.2022, informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në gjykim çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasit A. L. dhe B. H.

19.5. Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me burimin e te ardhurave për shlyerjen e këtyre huave.

Qëndrimi i subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

19.6. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se: *“Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kthimin e huave marrë nga babai im shtetasve B. H. dhe A. L., përveç sa më sipër, vlerësoj të theksoj gjithashtu se, në referim të praktikës së Kolegjtit të Posaçëm të Apelimit, konkretisht të qëndrimit të mbajtur në vendimin nr. 18, datë 26.7.2019, që një subjekt rivlerësimi të ngarkohet me barrë prove për një marrëdhënie huaje duhet që midis subjektit të rivlerësimit dhe huadhënësit apo huamarrësit të provohet marrëdhënia e interesit në kuptim të paragrafit 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Ritheksoj se unë, si subjekt rivlerësimi, nuk jam e përfshirë as në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë në marrëdhëniet e huave të babait tim e, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohem me barrë prove në lidhje me to. Këto hua nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie për mua, prindërit apo motrën time.*

*Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, ju sqaroj se babai më ka bërë me dije se shumat e marra hua ia ka dhënë hua vëllait tim E. G. dhe sipas tij vëllai i ka përdorur për nevoja të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. (shoqëri në të cilën është ortak dhe administrator i vetëm). Ata më kanë bërë me dije se duke qenë në marrëdhënie të posaçme (prind-fëmijë) nuk i kanë formalizuar me ndonjë akt shkresor këto veprime.*

Në lidhje me huan me huadhënës shtetasin A. L. dhe huamarrës babain tim F. G., sqaroj se kjo hua është shlyer nga babai im në dy këste të barabarta, njëra në vitin 2017 dhe tjetra në vitin 2020. Shlyerja e një pjese të detyrimit në vitin 2017 provohet nga deklarata noteriale, si dhe depozitimi i kryer në bankë nga vetë shtetasi A. L. në këtë vit. Ndërsa shlyerja e pjesës tjetër të detyrimit nëpërmjet bankës në vitin 2020 në vlerën 20.000 euro, provohet edhe nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, nga ku rezulton se në datën 27.4.2020 shtetasi F. G. ka kaluar në llogarinë e shtetasit A. L. shumën prej 20.000 euro, me shënimin ‘kthim borxhi’, dokumente këto të cilat ju i dispononi për shkak të administrimit të dosjes së rivlerësimit të motrës sime D. G.

*Në lidhje me burimin e ligjshëm për kthimin e shumave, sqaroj se babai dhe vëllai më kanë bërë me dije se si burim kanë shërbyer vetë shumat e marra hua, pasi këto nuk janë konsumuar, thjesht janë përdorur si qarkullim financiar nga vëllai im E. G. për shoqërinë e tij ‘***’ sh.p.k.*

*Vlerat e marra hua nuk janë konsumuar, por vetëm janë përdorur (qarkulluar) për furnizime, pra për blerje produktesh për shoqërinë tregtare ‘***’ sh.p.k. dhe pasi këto produkte janë rishitur nga shumat e fituara është kthyer sërish pas huaja. Vlerësoj se nga pasqyrat financiare të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., të cilat janë administruar nga ana juaj, rezulton e provuar se qarkullimet dhe fitimet në vitet përkatëse kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar financiarisht kthimin e këtyre shumave me burime të ligjshme.*

Në arritjen e përfundimit për mospërfshirjen time si subjekt në këto marrëdhënie financiare huaje në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, vlerësoj se duhet të mbahen në konsideratë këto rrethana: (i) destinacioni i përdorimit të shumave të marrë hua nga babai i im dhe burimet me të cilat ato janë shlyer; (ii) mospërfshirja ime si subjekt as për përdorimin (qoftë edhe të

pjesëshëm) të këtyre huave dhe mospasja e ndonjë kontributi as për kthimin pas të këtyre shumave, për sa kohë këto shuma nuk janë investuar në pasuri të familjareve të mi apo të miat, por janë përdorur përkohësisht nga shoqëria tregtare e vëllait tim dhe më pas u janë kthyer huadhënësve. Po ashtu, sa i takon huas së marrë shtetasit B. H., duhet mbajtur në konsideratë fakti se kjo hua është marrë nga babai im në tetor të vitit 2016, pasi unë isha shkëputur ligjërisht nga trangu familjar”.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

19.7. Trupi gjykues, pasi administroi provat e mbledhura gjatë hetimit, provat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, i konsideroi ato të mjaftueshme dhe bindëse.

19.8. Nga hetimi nga nuk ka rezultuar ndonjë *indicie* apo rrethanë faktike që të përfshijë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë subjektin e rivlerësimit në këtë marrëdhënie huaje (marrje dhe kthim).

19.9. Qëndrimi i mësipërm provohet edhe nga: (i) fakti se kjo hua është marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit në tetor të vitit 2016, pasi subjekti ishte shkëputur ligjërisht nga trangu familjar (moment i cili do të mund të ndikojë në përcaktimin dhe vlerësimin ligjor nëse kjo hua duhet të trajtohet si e marrë nga personi i lidhur, pra nga babai i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016); (ii) destinacioni i përdorimit të shumës së marrë hua nga babai i subjektit dhe burimet me të cilat ajo është shlyer; (iii) mospërfshirja e subjektit as për përdorimin (qoftë edhe të pjesëshëm) e kësaj huaje dhe mospasjen e ndonjë kontributi të subjektit, si dhe as për kthimin pas të kësaj shume.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

20. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj.

20.1. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj.

20.2. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e saj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ajo nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi.

20.3. Komisioni, pas hetimit të kryer, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLI I FIGURËS

21. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë

Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 26.10.2017, i deklasifikuar plotësisht⁶, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

21.1. Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Oltjona Goxha.

21.2. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit Oltjona Goxha, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

22. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

23. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreut VI, nenet 40 e vijues i tij, si dhe mbi bazën e kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar.

23.1. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

C/1. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokument 1 – vendimi nr. ***, datë 16.2.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditëse M. Ç., i paditur Q. Ç., me objekt “zgjdhje martesë etj.”. Çështja është gjykuar në

⁶Vendim nr. ***, datë 1.12.2020, i KDZH-së.

seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 16.2.2016 dhe vendimi është dhënë po në këtë datë. Në përfundim është vendosur pranimi i padisë, zgjidhja e martesës etj. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 2.3.2016.

Dokument 2 – vendimi nr. ***, datë 20.4.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket të pandehurit R. T., i akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Seanca është zhvilluar në datën 20.4.2016 dhe vendimi është dhënë po në këtë datë. Në përfundim është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 30.4.2016.

Dokument 3 – vendimi nr. ***, datë 9.6.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës shoqëria “****” sh.p.k., i paditur shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “përmbushje e detyrimit kontraktor, pagesa e shumës 10.332 euro, si dhe kamatëvonesat”. Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 9.6.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 9.6.2016. Në përfundim është vendosur pranimi i padisë. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 21.7.2016.

Pas analizimit të tri dosjeve të vëzhguara, Grupi i Punës ka konstatuar se:

- Në tri vendimet e subjektit nuk pasqyrohet data e regjistrimit të çështjes për gjykim, por është pasqyruar vetëm numri i aktit. Në këto kushte, nuk mund të arrihet në përfundim për afatin e gjykimit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Në lidhje me konstatimet tuaja për çështjen që i përket vendimit nr. ***, datë 16.2.2016 (nr. *** akti); vendimit nr. ***, datë 20.4.2016 (nr. *** akti); vendimit nr. ***, datë 9.6.2016 (nr. *** akti), ku thuhet se nuk pasqyrohet data e regjistrimit të këtyre çështjeve dhe nuk mund të konkludohet për afatin e gjykimit sqaroj si vijon: Çështja që i përket vendimit nr. ***, datë 16.2.2016 (nr. *** akti), është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 20.1.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 16.2.2016, pra rezulton që kjo çështje është gjykuar nga ana ime në më pak se një muaj, brenda 26 ditëve; çështja që i përket vendimit nr. ***, datë 9.6.2016 (nr. *** akti) është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 4.3.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 9.6.2016, pra rezulton që edhe kjo çështje është gjykuar nga ana ime brenda afatit orientues të KLD-së, pasi është gjykuar për 3 muaj e 5 ditë; çështja që i përket vendimit nr. ***, datë 20.4.2016 (nr. *** akti) është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.3.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 20.4.2016, pra rezulton që edhe kjo çështje është gjykuar nga ana ime brenda afatit orientues të KLD-së, për 1 muaj e 9 ditë”*.

Subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës dokumentacionin ligjor provues, fletët e regjistrimit për çështjen që i përket: vendimit nr. ***, datë 16.2.2016 (nr. *** akti); vendimit nr. ***, datë 20.4.2016 (nr. *** akti); dhe vendimit nr. ***, datë 9.6.2016 (nr. *** akti).

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, vlerëson se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe ligjore se nga ana e saj është respektuar afati 6-mujor i përcaktuar nga germa “e” e pikës 5 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Dokumentacioni ligjor provues i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit provon se kohëzgjatja e gjykimeve ka rezultuar brenda afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, pasi: çështja që i përket vendimit nr. ***, datë 16.2.2016 (nr. *** akti)⁷ është gjykuar nga ana e subjektit në më pak se një muaj; çështja që i përket vendimit nr. ***, datë 9.6.2016 (nr. *** akti)⁸ është gjykuar nga ana e subjektit për 3 muaj e 5 ditë; dhe çështja që i përket vendimit nr. ***, datë 20.4.2016 (nr. *** akti)⁹ është gjykuar për 1 muaj e 9 ditë.

C/2. Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja 1 – çështja civile nr. *** regj., datë 15.1.2016 regjistrimi, që i përket paditësit Z. D., kundër të paditurit OSHEE, me objekt “dëmshtëpërblim nga marrëdhëniet e punës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 11.3.2016.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regj., datë 5.4.2016 regjistrimi, që i përket paditësit “****” sh.p.k., kundër të paditurit “****” sh.p.k., me objekt “detyrimin e palës së paditur të përmbushë detyrimin sipas kontratës së shërbimit nr. *** prot., datë 5.9.2012, dëmshtëpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e mospagesës etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.6.2016.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regj. themeltar, datë 21.1.2016 regjistrimi, që i përket paditësit M. H., e paditur E. H., me objekt “zgjidhje martesë”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.2.2016.

Dosja 4 – çështja penale nr. *** regj., datë 17.3.2016 regjistrimi, që i përket të pandehurit A. S., akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 11.5.2016.

Dosja 5 – çështja penale (masë sigurimi) nr. ***, datë 16.5.2016, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vlefhtësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit J. C. për veprën penale ‘prodhim dhe shitje të narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin, nr. s’ka, datë 17.5.2016.

Pas analizimit të pesë dosjeve të vëzhguara, Grupi i Punës ka konstatuar se:

- Në dosjet nr. 1, 2 dhe 3 seancat përgatitore dhe gjyqësore nuk dokumentohen të jenë zhvilluar në sallë gjykimi, si dhe nuk janë regjistruar audio sipas udhëzimit nr. ***, datë 3.9.2013, të ministrit të Drejtësisë dhe nenit 118/1 të Kodit të Procedurës Civile.
- Në dosjen 4, për çështjen penale nr. *** regj., datë 17.3.2016 regjistrimi, që i përket të pandehurit A. S., akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, dosja gjyqësore dhe vendimi

⁷Regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 20.1.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 16.02.2016.

⁸Regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 4.3.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 9.6.2016.

⁹Regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.3.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 20.4.2016.

përfundimtar është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në sekretari në datën 18.5.2016, 7 ditë nga shpallja e vendimit, pra jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

- Në dosjen 5, për çështjen penale (masë sigurimi) nr. ***, datë 16.5.2016, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit J. C. për veprën penale ‘prodhim dhe shitje të narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal”, është konstatuar që vendimi datë 17.5.2016 nuk përmban numër.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Në lidhje me konstatimin e Komisionit se dosjet 1, 2 dhe 3 nuk konstatohen të jenë zhvilluar në salla gjykimi dhe nuk janë regjistruar audio, sqaroj se këto çështje janë gjykuar prej meje gjatë kohës që kam kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (viti i 3-të i Shkollës së Magjistraturës). Gjatë kohës që kam kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate ka qenë evidente mungesa e sallave e gjykimit dhe e atyre ku mundësohej regjistrimi audio. Në këtë gjykatë sallat e gjykimit me regjistrim audio kanë qenë të planifikuara sipas një kalendari të caktuar për t’u shfrytëzuar nga gjyqtarët që ushtronin detyrën në të. Të gjithë magjistratët që kryenim stazhin profesional nuk kemi qenë të caktuar në këtë grafik dhe ka qenë praktikisht e pamundur për ne që të shfrytëzonim sallat e gjykimit me regjistrim audio. Bëj me dije se edhe akomodimi jonë pranë gjykatës gjatë kësaj kohe ka qenë në zyra të përshtatura si të tilla për ne, në korridoret hyrëse për publikun në gjykatë, me nga dy gjyqtarë stazhierë në secilën zyrë, me një sekretare gjyqësore për dy gjyqtarë. Sqaroj gjithashtu se edhe oraret e seancave rakordoheshin midis nesh për të mos krijuar mbivendosje të orareve të gjykimeve të planifikuara. Pra shkak i moszhvillimit të seancave gjyqësore në sallë dhe me regjistrim audio ka qenë mungesa e infrastrukturës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkak që nuk kushtëzohej prej vullnetit tim tej çdo mundësie.*

*Në lidhje me konstatimin e Komisionit se në çështjen penale nr. *** regj., datë 17.3.2016, vendimi është depozituar në sekretari në datën 18.5.2016, 7 ditë pas shpalljes, 2 ditë jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, sqaron se i është dorëzuar sekretares gjyqësore vendimi së bashku me dosjen brenda afatit 5-ditor dhe pjesa tjetër e afatit i është nevojitur asaj për kryerjen e procedurave administrative, numërtimi, qepja e dosjes, hedhja në sistem, anonimizimi, dorëzimi fizikisht në kryesekretari etj.*

*Sa i takon konstatimit të Komisionit se çështja penale masë sigurimi nr. ***, datë 16.5.2016 regj., datë 17.5.2016 vendimi, nuk ka numër vendimi, sqaroj se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesat penale, siç është edhe ajo e sipërcituar, nuk numërtohen. Pra, ato nuk marrin numër vendimi, kjo është edhe arsyeja pse vendimi ka vetëm numër regjistrimi (akti) dhe jo numër vendimi”.*

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, arsyeton si vijon:

- Në lidhje me konstatimin se dosjet gjyqësore nr. 1, 2 dhe 3 nuk janë zhvilluar në salla gjykimi dhe nuk janë regjistruar audio, Komisioni vlerëson se subjekti arriti të shpjegojë në mënyrë bindëse se moszhvillimi me regjistrim audio nuk kushtëzohet prej vullnetit të subjektit, për arsye se: (i) ka pasur mungesë të sallave të gjykimit ku mundësohet regjistrimi audio; (ii) sallat e gjykimit me regjistrim audio kanë qenë të planifikuara sipas një kalendari të caktuar për t'u shfrytëzuar nga gjyqtarët që ushtronin detyrën në të; (iii) seancat gjyqësore të sipërcituara janë zhvilluar në kohën e stazhit dhe se stazhierët nuk kanë qenë të caktuar në kalendar; dhe (iv) mungesa e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Ndërsa, sa i takon konstatimit se në çështjen penale nr. *** regj., vendimi është depozituar në sekretari jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm se rrethanat e vonës në depozitim nuk vareshin nga vullneti i saj, pasi pjesa tjetër e afatit i është nevojitur sekretarisë për kryerjen e procedurave administrative. Për rrjedhojë, lidhur me këtë konstatim, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së

24. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Oltjona Goxha ka përfunduar studimet pranë universitetit “***” në degën Drejtësi, me titull “Jurist”, në datën 12.7.2007 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016. Me Dekretin Nr. ***, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës, emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, caktohet për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku edhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

24.1. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Oltjona Goxha nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

24.2. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Oltjona Goxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

ANALIZA E GJETJEVE

Aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste ajo përdor referenca në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë apo GJEDNJ-së, në dispozitat kushtetuese, KEDNJ, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, si dhe në ligjet specifike si ligji “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

Ndër pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar 4 vendime gjyqësore të dhënë prej saj dhe gjykata e apelit ka vendosur për dy çështje lënien në fuqi të vendimit, për një çështje ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të heqjes dorë prej tij dhe për një çështje ka miratuar

vendimin lidhur me vleftësimin e ligjshëm të arrestimit dhe ndryshuar masën e sigurimit nga “arrest në burg” në “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Për dy nga këto dosje rezultojnë të jetë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja është ende në pritje për t’u gjykuar. Ndërsa në një rast vendimi i dhënë nga gjyqtarja Oltjona Goxha nuk është ankimuar. Për sa i përket tri dokumenteve ligjore, nga aktet e paraqitura rezultojnë se për të tria vendimet nuk është paraqitur ankim dhe vendimet kanë marrë formë të prerë në gjykatën e shkallës së parë.

Së fundmi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj gjyqtarës Oltjona Goxha nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezultojnë që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

b. Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementet e përcaktuara nga ligji procedural civil e penal, janë të ndara në tri pjesë dhe janë të qarta e të kuptueshme. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët, sipas rastit edhe për palët në mungesë. Ajo i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku pasqyrohet saktë shkaku dhe baza ligjore.

Aftësitë organizative

a. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave konstatohet se subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha e respekton kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe i ka gjykuar të gjitha çështjet brenda afateve standarde të ligjore të gjyqimit, qofshin çështje penale apo civile. Gjithashtu, ajo i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet.

b. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt nga brenda ditës së shortit – 10 ditë nga marrja e çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Gjatë gjyqimit gjyqtarja Oltjona Goxha zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjyqimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural merr rregullisht

mendimin e palëve në gjykim. Ajo i kushton rëndësi kërkimeve procedurale të palëve, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për veprime procedurale të kryera gjatë gjykimit. Ajo ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar përfaqësues ligjor, ka caktuar mbrojtës kryesisht kur është kërkuar nga i pandehuri, i cili ka qenë në pamundësi ekonomike për të zgjedhur mbrojtës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a. Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Oltjona Goxha. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarën Oltjona Goxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b. Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c. Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Oltjona Goxha. Për vetë gjyqtarën në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. Në tri dokumentet ligjore të paraqitura dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar as përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a. Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Oltjona Goxha komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b. Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Oltjona Goxha për të bashkëpunuar me kolegët (çështjet janë gjykuar me gjyqtar të vetëm subjektin e rivlerësimit) dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti

ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga vëzhgimi i dosjeve rezulton se nuk ka pasur dështim të seancave të planifikuara apo vonesa për fillimin e seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Subjekti e ka realizuar arsyetimin e vendimeve brenda afateve ligjore, çka tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c. Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Oltjona Goxha i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale

25. Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme; dhe (ii) në gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIME

26. Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka analizuar 3 denoncimet e ardhura për subjektin e rivlerësimit, nga ku ka rezultuar si vijon:

26.1. Denoncim nr. * prot., datë 6.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 29.2.2022, të V. Ç.**

Shtetasi V. Ç. pretendon se disa subjekte, ndërmjet tyre edhe subjekti i rivlerësimit, mbrojnë abuzuesit e ligjit, si dhe korrupsionin e organizuar. Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentet, si vijon: (i) vendimin për mosfillimin e procedimit penal datë 19.7.2017, për kallëzimin penal nr. *** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; si dhe (ii) vendimin për përjashtim gjyqtari, me nr. *** regj., datë 22.11.2017, me kërkues V. Ç.. Konkretisht, lidhur me subjektin e rivlerësimit, denoncuesi pretendon se vendimi me nr. *** regj., datë 22.11.2017, për mospranimin e kërkesës penale me objekt “përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes penale”, është një vendim i mirëfilltë kriminal që mbron hapur falsifikimet në dosje nëpërmjet procesverbaleve të seancave gjyqësore.

Nga analiza e vendimit rezulton se kërkesa e paraqitur nga denoncuesi nuk plotëson nga ana formale kushtet e parashikuara në nenin 19 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, në vendimin e marrë nga subjekti disponohet se nuk provohet se nga ana e trupit gjykues të jenë shprehur opinione paraprake apo qëndrime subjektive rreth objektit të kërkesës. Konkretisht, në vendim citohet se: “...nuk është i mjaftueshëm një pretendim i përgjithshëm dhe abstrakt i palës sa i takon njëanshmërisë së gjyqtarit për ta konsideruar këtë të fundit si të njëanshëm, për më tepër pretendimet e kërkuesit lidhur me mënyrën e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore, jo vetëm që janë pretendime që nuk mund të jenë objekt i gjykimit të kërkesës për përjashtim gjyqtari, por nuk qëndrojnë”.

Në këto kushte nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit dhe ka të bëjë kryesisht me themelin e çështjes gjyqësore.

26.2. Denoncim nr. * prot., datë 5.4.2022, i shtetases E. C.,** drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, për mosfillimin e procedimit penal. Më konkretisht, denoncuesja pretendon për subjektin e rivlerësimit se ka qenë e njëanshme pasi dërgoi fletëthirrjen e gjyqit në adresë të gabuar, si dhe në seancën e datës 4.4.2022 ka shkelur çdo kod të profesionalizmit dhe të detyrës.

Nga dokumentet e dorëzuara rezulton se denoncuesja është njoftuar rregullisht nga gjykata për datën e seancës, pasi fletëthirrja përmban nënshkrimin e denoncuesit në cilësinë e marrësit të njoftimit. Gjithashtu, nga dokumentacioni i depozituar nuk konstatohet që denoncuesja gjatë procesit gjyqësor të ketë bërë kërkesë për përjashtimin e subjektit për arsye paanshmërie.

Konkluzioni i Komisionit për denoncimet

27. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e gjyqtarit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, nenit 58, germa “a” e pikës 1 dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Oltjona Goxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 27.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI

Kryesues

Xhensila PINE

Relatore

Firdes SHULI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Jonida Vrana